



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-12/IA001

Vendosi: **Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit**
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Emilio Gati
Gjykatëse Nina Jorgensen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 28 janar 2025

Gjuha origjinale: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Apelin e Isni Kilajt kundër Vendimit mbi Vazhdimin e
Paraburgimit**

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit:
Nina Tavakoli

Mbrojtësit kujdestar të Bashkim Smakajt:
Bas Martens

Mbrojtjes së Isni Kilajt:
Ian Edwards

Mbrojtësit kujdestar të Fadil Fazliut:
Mihil Pestman

Mbrojtësit kujdestar të Hajredin Kuçit:
Aleksandër Admiral

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT i Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, “Paneli i Gjykatës së Apelit”, “Paneli i Apelit” ose “Paneli” dhe “Dhomat e Specializuara”),¹ në bazë të nenit 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji) dhe rregullës 169 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave (“Rregullorja), ka marrë në shqyrtim apelin e dorëzuar më 19 dhjetor 2024 nga z. Isni Kilaj (përkatësisht, “Apeli” dhe “Kilaj” ose “i akuzuari”),² kundër Vendimit Gojor të Gjykatës së Procedurës Paraprake mbi Vazhdimin e Paraburgimit (“Vendimi i Apeluar”).³ Zyra e Prokurorit të Specializuar u përgjigj më 2 janar 2025 se Apeli duhej të rrëzohej.⁴ Kilaj u kundërpërgjigj më 7 janar 2025.⁵

I. HISTORIKU

1. Më 2 nëntor 2023, Kilaj u arrestua në Kosovë në bazë të urdhrit të lëshuar nga ZPS-ja⁶ dhe më 3 nëntor 2023, u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“objekti i paraburgimit”) në Hagë, Holandë.⁷

¹ IA001/F00002, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 23 dhjetor 2024 (konfidencial, u riklasifikua si publik më 22 janar 2025).

² IA001/F00001/COR, Version i Korrigjuar i Apelit të Kilajt kundër Vendimit mbi Vazhdimin e Paraburgimit, 31 dhjetor 2024 (konfidencial) (versioni i pakorrigjuar u dorëzua më 19 dhjetor 2024) (“Apeli”).

³ Transkripti, 9 dhjetor 2024, f. 120-124 (“Vendimi i Apeluar”).

⁴ IA001/F00003, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Apelit të Kilajt kundër Vendimit mbi Vazhdimin e Paraburgimit, 2 janar 2025 (konfidenciale) (“Përgjigja”).

⁵ IA001/F00004, Kundërpërgjigje e Kilajt ndaj Përgjigjes së Prokurorisë lidhur me Apelin e Kilajt kundër Vendimit mbi Vazhdimin e Paraburgimit, 7 janar 2025 (konfidenciale) (“Kundërpërgjigja”).

⁶ KSC-BC-2018-01, F00489, Njoftim Urgjent sipas Rregullës 52(1) për Arrestimin e Isni Kilajt, 2 nëntor 2023 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, u riklasifikua si publik më 9 nëntor 2023); KSC-BC-2018-01, F00492/RED/A01/RED, Version i Redaktuar Publik i Shtojcës 1 të Raportit të Prokurorisë për Arrestimin e Isni Kilajt, 8 nëntor 2023 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 3 nëntor 2023, u riklasifikua si konfidencial më 3 nëntor 2023).

⁷ KSC-BC-2018-01, F00495/RED, Version i Redaktuar Publik i Raportit për Transferimin e Isni Kilajt në Objektin e Paraburgimit, me Shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (F00495), 8 nëntor 2023 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 3 nëntor 2023); KSC-BC-2018-01, F00493, Njoftim për Pranimin e Isni Kilajt në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 3 nëntor 2023 (rreptësisht konfidencial).

2. Më 6 nëntor 2023, Gjykatësi i Vetëm urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Kilajt ("Vendimi i Parë mbi Paraburgimin").⁸ Gjithashtu, Gjykatësi i Vetëm shqyrtoi dhe urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Kilajt më 5 janar 2024 ("Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin")⁹ dhe më 5 mars 2024.¹⁰ Si Vendimi i Parë mbi Paraburgimin dhe Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin u konfirmuan nga Paneli i Gjykatës së Apelit (përkatësisht, "Vendi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin"¹¹ dhe "Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin"¹²).

3. Më 15 dhjetor 2023, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën për konfirmim kundër disa personave, ndër të cilët Kilaj.¹³

4. Më 11 mars 2024, në bazë të urdhrit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,¹⁴ ZPS-ja dorëzoi aktakuzën e rishikuar ("Aktakuza e Rishikuar").¹⁵

5. Më 2 maj 2024, ndër të tjera, ZPS-ja kërkoi pezullimin e shqyrtimit të Aktakuzës së Rishikuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake deri në dorëzimin e materialeve

⁸ KSC-BC-2018-01, F00499, Vendim mbi Vazhdimin e Paraburgimit, 6 nëntor 2023 ("Vendimi mbi Vazhdimin e Paraburgimit"). Gjykatësi i Vetëm paraqiti arsyet për atë vendim më 9 nëntor 2023. *Shih* KSC-BC-2018-01, F00503/RED, Version i Redaktuar Publik i Arsyeve për Vazhdimin e Paraburgimit, 13 nëntor 2023 (versioni konfidencial u dorëzua më 9 nëntor 2023) ("Arsyet për Vazhdimin e Paraburgimit"). Paneli i Apelit do t'u referohet Vendimit mbi Vazhdimin e Paraburgimit dhe Arsyeve për Vazhdimin e Paraburgimit si "Vendimi i Parë mbi Paraburgimin".

⁹ KSC-BC-2018-01, F00547/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt, 18 janar 2024 (versioni konfidencial u dorëzua më 5 janar 2024) ("Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin").

¹⁰ KSC-BC-2018-01, F00603/RED Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt, 11 mars 2024 (versioni konfidencial u dorëzua më 5 mars 2024) ("Vendimi i Tretë mbi Paraburgimin").

¹¹ KSC-BC-2018-01, IA004/F00006/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin të Isni Kilajt kundër Vendimit mbi Vazhdimin e Paraburgimit, 11 janar 2024 (versioni konfidencial u dorëzua më 11 janar 2024) ("Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin").

¹² KSC-BC-2018-01, IA005/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Isni Kilajt kundër Vendimit mbi Vazhdimin e Paraburgimit, 26 shkurt 2024 (versioni konfidencial u dorëzua më 26 shkurt 2024) ("Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin").

¹³ F00002, Parashtrim i Aktakuzës për Konfirmim dhe Kërkesës lidhur me Të, 15 dhjetor 2023 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*).

¹⁴ F00004, Urdhër Prokurores së Specializuar sipas Rregullës 86(4) të Rregullores, 22 shkurt 2024 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*).

¹⁵ F00007, Parashtrim i Aktakuzës së Rishikuar për Konfirmim, 11 mars 2024 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*); F00007/A01, Aktakuzë, 11 mars 2024 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*).

mbështetëse shtesë dhe të aktakuzës së ndryshuar ("Kërkesa e ZPS-së për Leje dhe Pezullim").¹⁶

6. Më 3 maj 2024, Gjykatësi i Vetëm urdhëroi lirim të Kilajt në Kosovë, objekt i kushteve të rrepta, pasi e konstatoi të paarsyeshëm vazhdimin e paraburgimit të tij, duke pasur parasysh Kërkesën e ZPS-së për Leje dhe Pezullim, dhe rrjedhimisht në pritje të dorëzimit të aktakuzës së ndryshuar më tej kundër Kilajt ("Vendimi për Lirim").¹⁷ Vendimi për Lirim u konfirmua nga Paneli i Apelit më 13 maj 2024,¹⁸ dhe Kilaj u transferua në Kosovë dhe u lirua nga paraburgimi i Dhomave të Specializuara më 15 maj 2024.¹⁹

7. Më 20 qershor 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rrëzoi Kërkesën e ZPS-së për Leje dhe Pezullim.²⁰

8. Më 28 qershor 2024, ZPS-ja paraqiti për konfirmim aktakuzën e ndryshuar kundër z. Hashim Thaçi ("Thaçi"), z. Bashkim Smakaj ("Smakaj"), Kilajt, z. Fadil Fazliu ("Fazliu"), dhe z. Hajredin Kuçi (përkatesisht "Kuçi" dhe "pesë të akuzuarit").²¹

¹⁶ F00014, Parashtrime të Prokurorisë sipas Urdhrit F00011, 2 maj 2024 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*). Paneli thekson se më të njëjtën ditë, ZPS-ja gjithashtu informoi Gjykatësin e Vetëm për kërkesën dhe synimin e vet për të dorëzuar aktakuzën e ndryshuar. *Shih* KSC-BC-2018-01, F00654, Njoftim Plotësues i Prokurorisë, 2 maj 2024 (konfidencial). *Shih gjithashtu* KSC-BC-2018-01, F00636, Njoftim Plotësues i Prokurorisë, 19 prill 2024 (versioni konfidencial u riklasifikua si publik më 19 prill 2024).

¹⁷ KSC-BC-2018-01, F00658/COR/RED, Version i Redaktuar Publik i Versionit të Korrigjuar të Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt, 15 maj 2024 (versioni konfidencial dhe i pakorrigjuar u dorëzua më 3 maj 2024, versioni konfidencial dhe i pakorrigjuar u dorëzua më 15 maj 2024), ("Vendimi për Lirim"), para. 64-65, 70(a) dhe (c).

¹⁸ KSC-BC-2018-01, IA007/F00007/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Isni Kilajt, 15 maj 2024 (versioni konfidencial u dorëzua më 13 maj 2024) ("Vendimi i Apelit për Lirim").

¹⁹ KSC-BC-2018-01, IA007/F00008, Njoftim për Transferimin e Isni Kilajt në Kosovë, 15 maj 2024 (konfidencial, u riklasifikua si publik më 7 gusht 2024).

²⁰ F00016, Vendim mbi Kërkesat e Prokurorisë për Leje për të Paraqitur Material Shtesë dhe për Pezullimin e Shqyrtimit të Aktakuzës, 20 qershor 2024 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*).

²¹ F00017, Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar për Konfirmim, 28 qershor 2024 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*); F00017/A01, Aktakuzë e Ndryshuar, 28 qershor 2024 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*).

Më 12 nëntor 2024, në bazë të urdhrit të lëshuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake, ZPS-ja dorëzoi për konfirmim Aktakuzën e Ndryshuar më Tej.²²

9. Më 29 nëntor 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin mbi Konfirmimin e Aktakuzës, me të cilin konfirmoi – pjesërisht – akuzat kundër pesë të akuzuarve.²³ Në veçanti, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konfirmoi akuzat kundër Kilajt për tentativë për pengim, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, të personave zyrtarë, përfshirë të prokurorëve dhe hetuesve të ZPS-së në kryerjen e detyrave zyrtare, e ndëshkueshme sipas neneve 17, 21, 33, 35 dhe 40(2) dhe (5) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodi nr. 06/L-074 (2019) ("KPK") dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit; dhe për mosbindje ndaj gjykatës, e ndëshkueshme në bazë të neneve 21, 33 dhe 393 të KPK-së dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.²⁴

10. Më të njëjtën ditë, me kërkesë të ZPS-së,²⁵ Gjykatësja e Procedurës Paraprake ndërpreu lirimin me kusht në Kilajt në Kosovë, lëshoi fletarrestimin dhe urdhëroi transferimin e tij në objektin e paraburgimit ("Vendimi mbi Fletarrestimet").²⁶

11. Më 2 dhjetor 2024, ZPS-ja dorëzoi aktakuzën, sikurse është konfirmuar ("Aktakuza e Konfirmuar").²⁷

²² F00028, Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar më Tej për Konfirmim, 12 nëntor 2024 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, u riklasifikua si konfidencial më 13 janar 2025); F00028/A01, Aktakuzë e Ndryshuar më Tej, 12 nëntor 2024 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, u riklasifikua si konfidenciale më 13 janar 2025) ("Aktakuza e Ndryshuar më Tej").

²³ F00036, Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës, 29 nëntor 2024 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, u riklasifikua si konfidencial më 13 dhjetor 2024).

²⁴ Vendimi i Konfirmimit, para. 313(d).

²⁵ F00023/RED, Version i Redaktuar Publik i Parashtrimeve të Prokurorisë sipas Parashtrimit F00022 me Shtojcat 1-5, Rreptësisht Konfidenciale dhe Ex Parte, 13 dhjetor 2024 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 17 tetor 2024). Shih gjithashtu F00022, Urdhër për Parashtrime, 8 tetor 2024 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*).

²⁶ F00037/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimeve dhe Çështje Përkatëse, 19 dhjetor 2024 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 29 nëntor 2024, u riklasifikua si konfidencial më 6 dhjetor 2024) ("Vendimi mbi Fletarrestimet"), para. 68; F00037/A03, Fletarrestim për Isni Kilajn, 29 nëntor 2024 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*).

²⁷ F00055, Parashtrim i Versionit të Redaktuar Publik të Aktakuzës së Konfirmuar, 6 dhjetor 2024; F00055/A01, Aktakuzë e Konfirmuar e Redaktuar Publike, 6 dhjetor 2024 ("Aktakuza e Konfirmuar").

12. Më 5 dhjetor 2024, Kilaj u arrestua në Kosovë dhe, më 6 dhjetor 2024, u transferua në objektin e paraburgimit.²⁸

13. Më 9 dhjetor 2024, Kilaj u paraqit para Gjykatësës së Procedurës Paraprake e cila dëgjoi parashkrimet gojore të Mbrojtjes²⁹ dhe të ZPS-së³⁰ në lidhje me paraburgimin ("seanca e paraqitjes së parë"). Në atë seancë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi Vendimin e Apeluar me të cilin urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Kilajt.³¹

14. Në Apel, Kilaj argumenton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake keqpërdori diskrecionin e saj dhe për këtë arsye kërkon që Paneli i Gjykatës së Apelit të miratojë Apelin, të prapësojë Vendimin e Apeluar dhe të urdhërojë lirimin e menjëhershëm të tij.³² ZPS-ja përgjigjet se Kilaj nuk ka arritur të demonstrojë ndonjë gabim në Vendimin e Apeluar dhe se Apeli duhet të rrëzohet.³³

Shih gjithashtu F00040, Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar, 2 dhjetor 2024 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, u riklasifikua si rreptësisht konfidencial më 3 dhjetor 2024); F00040/A01, Aktakuzë e Konfirmuar, 2 dhjetor 2024 (rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, u riklasifikua si rreptësisht konfidenciale më 3 dhjetor 2024).

²⁸ F00067/RED, Version i Redaktuar Publik i Raportit për Arrestimin dhe Transferimin e Isni Kilajt në Objektin e Paraburgimit, 10 janar 2025 (versioni rreptësisht konfidencial dhe *ex parte* u dorëzua më 8 dhjetor 2024, u riklasifikua si konfidencial dhe *ex parte* më 17 dhjetor 2024); F00056, Njoftim për Pranimin e Isni Kilajt në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara, 6 dhjetor 2024 (rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, u riklasifikua si publik më 17 dhjetor 2024).

²⁹ Vendimi i Apeluar, f. 96-115, 119.

³⁰ Vendimi i Apeluar, f. 115-118.

³¹ Vendimi i Apeluar, f. 122-123. Gjykatësja e Procedurës Paraprake bëri të ditur se arsyet për paraburgimin e Kilajt ishin të njëjta me ato të përcaktuara në paragrafët 43 dhe 56-67 në Vendimin mbi Fletarrestimet, të cilat duhet të lexoheshin së bashku me vendimin gojor. *Shih* Vendimin e Apeluar, f. 123. Paneli thekson se në Vendimin e Apeluar, Gjykatësja e Procedurës Paraprake kryesisht i referohet konstatimeve relevante që lidhen me Vendimin mbi Fletarrestimet. *Shih* Vendimin e Apeluar, f. 122-123.

³² Apeli, para. 2, 33-34.

³³ Përgjigja, para. 1, 33.

II. STANDARDI I SHQYRTIMIT DHE DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

15. Paneli i Gjykatës së Apelit zbaton standardin e shqyrtimit për apelet e ndërmjetme të përcaktuar në vendimin e vet të parë dhe të zbatuar në vijimësi.³⁴

16. Paneli kujton se vendimet lidhur me mbajtjen në paraburgim janë diskrecionale.³⁵ Nëse vendimi që kundërshtohet është vendim diskrecional, pala duhet të demonstrojë se paneli i shkallës më të ulët ka kryer një gabim të dukshëm në kuptimin që vendimi: (i) është bazuar në interpretimin e pasaktë të ligjit në fuqi; (ii) është bazuar në një përfundim faktik qartësisht të pasaktë; ose (iii) është aq i padrejtë apo i paarsyeshëm saqë përbën keqpërdorim të diskrecionit nga paneli i shkallës më të ulët.³⁶ Paneli i Gjykatës së Apelit gjithashtu do të shqyrtojë nëse, gjatë marrjes së vendimit, paneli i shkallës më të ulët u ka dhënë peshë aspekteve të jashtme ose jorelevante, ose nuk u ka dhënë peshë apo nuk u ka dhënë peshë të mjaftueshme faktorëve relevantë.³⁷

17. Paneli gjithashtu kujton se, në bazë të nenit 41(6)(a) të Ligjit, paraburgimi i një personi urdhërohet vetëm nëse ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer një vepër penale që është nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara; dhe, sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit, ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se: (i) ekziston rreziku i arratisjes (ii) personi do të manipulojë provat, ose pengojë ecurinë e procesit penal; ose (iii) rrethanat tregojnë se ekziston rreziku që personi do ta përsërisë veprën penale, do të përfundojë një vepër penale të tentuar, ose do të kryejë një vepër penale që ka kërcënuar se do ta kryejë. Kushtet e përcaktuara në nenin 41(6)(b) të Ligjit janë

³⁴ KSC-BC-2020-07, IA001/F00005 Vendim mbi Apelin e Hysni Gucatit për Çështje të lidhura me Arrestimin dhe Mbajtjen e Tij në Paraburgim, 9 dhjetor 2020 ("Vendimi i Apelit mbi Paraburgimin e Gucatit"), para. 4-14. *Shih gjithashtu* Vendimin e Apelit mbi Paraburgimin, para. 14.

³⁵ Vendimi i Apelit mbi Paraburgimin, para. 15; Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin, para. 27; Vendimi i Apelit mbi Paraburgimin e *Gucatit*, para. 49, 51.

³⁶ Vendimi i Apelit mbi Paraburgimin, para. 16; Vendimi i Apelit mbi Paraburgimin e *Gucatit*, para. 14; KSC-BC-2020-06, IA001/F00005, Vendim mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, 30 prill 2021 ("Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Veselit"), para. 7.

³⁷ Vendimi i Apelit mbi Paraburgimin e *Gucatit*, para. 14; Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*, para. 7.

alternative ndaj njëri-tjetrit.³⁸ Në qoftë se përmbushet njëri prej këtyre kushteve, nuk është e nevojshme të shqyrtohen kushtet e tjera për vazhdimin e masës së paraburgimit.³⁹

III. ASPEKTE PARAPRAKE

A. PRANUESHMËRIA E PËRGJIGJES

18. Mbrojtja parashtroi se Përgjigjja u dorëzua jashtë afatit dhe duhet të rrëzohet.⁴⁰ Paneli kujton se: (i) përgjigjja ndaj apelit kundër vendimit për mbajtjen e një personi në paraburgim duhet të dorëzohet brenda dhjetë ditësh nga apeli;⁴¹ (ii) afati fillon prej ditës së parë të punës pas njoftimit të parashtrimit relevant;⁴² dhe (iii) nëse dita e fundit e afatit është në fundjavë ose ditë pushimi zyrtar e Dhomave të Specializuara, si ditë e fundit e afatit përkatës llogaritet dita vijuese e punës.⁴³

19. Në këtë rast, Paneli vë në dukje se Apeli iu njoftua gjykatësve dhe palëve të premtën, 20 dhjetor 2024.⁴⁴ Duke pasur parasysh se ishte fundjavë, llogaritja e afatit filloi të hënën, 23 dhjetor 2024. Dita e dhjetë e afatit ishte të mërkurën, 1 janar 2025, ditë pushimi zyrtar, që e shtyu afatin për të enjten, 2 janar 2025. Rrjedhimisht, Paneli konstaton se Përgjigjja u dorëzua brenda afatit.⁴⁵

³⁸ *Shih* KSC-BC-2020-07, IA007/ F00004 dhe IA008/F00004, Vendim Përmbledhës mbi Apelet e Nasim Haradinajt kundër Vendimeve mbi Rishikimin e Paraburgimit, 6 prill 2022 ("Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e *Haradinajt*"), para. 49; KSC-BC-2020-06, IA004/F00005, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, 30 prill 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 30 prill 2021) ("Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e *Thaçit*"), para. 78.

³⁹ Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e *Haradinajt*, para. 49; Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e *Thaçit*, para. 78.

⁴⁰ Kundërpërgjigjja, para. 3-7, 19.

⁴¹ Rregulla 58(1)-(2), 170(1) e Rregullores.

⁴² Rregulla 9(2) e Rregullores.

⁴³ Rregulla 9(4) e Rregullores. *Shih gjithashtu* Rregullën 9(1) ku përcaktohet se afatet llogariten në ditë kalendarike.

⁴⁴ Mesazh elektronik lidhur me njoftimin u dërgua nga NJAGJ-ja gjykatësve dhe palëve më 20 dhjetor 2024, në orën 12:27.

⁴⁵ *Shih më poshtë*, para. 26-30.

B. PARASHTRIMET PUBLIKE

20. Paneli kujton se të gjitha parashtrimet e dorëzuara në Dhomat e Specializuara janë publike, përveç nëse ka arsye të veçanta për t'i mbajtur konfidenciale dhe se palët duhet të dorëzojnë versionet e redaktuara publike të të gjitha parashtrimeve që i paraqesin Panelit. Duke qenë se ky Vendim nuk përmban informacion konfidencial, Paneli i Apelit e klasifikon atë si publik.

21. Paneli vë në dukje se parashtrimet e bëra nga palët u dorëzuan si konfidenciale. Paneli gjithashtu thekson se ZPS-ja nuk kundërshton riklasifikimin e Përgjigjes si publike. Për arsye se ajo nuk përmban informacion konfidencial, Paneli konstaton se Përgjigjja mund të riklasifikohet si publike. Paneli urdhëron Mbrojtjen të dorëzojë versionet e redaktuara publike të Apelit dhe të Kundërpërgjigjes, ose të bëjë të ditur, me anë të një parashtrimi, nëse ato mund të riklasifikohen si publike brenda dhjetë ditësh nga njoftimi i këtij vendimi.

IV. DISKUTIM

A. PARASHTRIMET E PALËVE

22. Sa i përket rrezikut të arratisjes, Kilaj kujton faktorët që Gjykatësja e Procedurës Paraprake mori parasysh për të përligjur paraburgimin e tij fillestar, por argumenton se vetëm faktorët pasi mësoi për Aktakuzën e Konfirmuar mund të përshkruhen me të drejtë si faktorë që i japin “motiv shtesë” për t'u arratisur.⁴⁶

23. Kilaj argumenton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake keqpërdori diskrecionin e saj “duke mos u dhënë peshë ose peshë të mjaftueshme fakteve që, me gjithë ekzistencën e faktorëve të mëhershëm, Gjykatësi i Vetëm megjithatë miratoi lirim me kusht për Kilajn në Vendimin për Lirimin”.⁴⁷ Kilaj gjithashtu argumenton se

⁴⁶ Apeli, para. 21-22.

⁴⁷ Apeli, para. 23; Kundërpërgjigjja, para. 11-12, 16-17. Kilaj gjithashtu argumenton se, kur miratoi lirim me kusht të tij më 3 maj 2024, Gjykatësi i Vetëm parashikoi posaçërisht vazhdimin e lirit të

demonstroi se atij mund t'i besohej që nuk do të arratisesh dhe nuk do t'i ikte drejtësisë dhe se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk dha shpjegim të arsyetuar se pse duhej t'i jepej kaq pak peshë provave për sjelljen e tij të mirë dhe përmbushjen e kushteve.⁴⁸

24. Lidhur me faktorët pasi Kilaj u vu në dijeni të Aktakuzës së Konfirmuar, ai argumenton se arsyet e Gjykatësës së Procedurës Paraprake për marrjen parasysh të këtyre faktorëve si motiv shtesë janë të mangëta.⁴⁹ Në lidhje me rrezikun e arratisjes Kilaj parashtroi se: (i) është i pasaktë konstatimi se pesha e veprave penale për të cilat akuzohet dhe kohëzgjatja e dënimit me të cilin përballet shkojnë më tej sesa parashikimi fillestar i Kilajt, sepse që prej konfirmimit të Aktakuzës ai është në dijeni se rrezikon një dënim maksimal që është në masë të ndjeshme më pak ndëshkues se në rrethanat kur iu miratua lirimi me kusht;⁵⁰ (ii) konstatimi se Kilaj do të vihet në dijeni të provave të paraqitura nga ZPS-ja në mbështetje të Aktakuzës së Konfirmuar dhe se kjo do të jetë motiv shtesë për t'u arratisur, është i paarsyeshëm sepse Kilaj ka qenë në dijeni të atyre provave që prej parashtrimeve të para të ZPS-së mbi rishikimin e paraburgimit më 15 dhjetor 2023;⁵¹ dhe (iii) Gjykatësja e Procedurës Paraprake i kushtoi shumë pak peshë faktit se një dënim i mundshëm me burgim afatgjatë tashmë është konkret dhe nuk mori parasysh se, që prej 15 dhjetorit 2023, Kilaj nuk ka pasur kurrfarë iluzioni se nuk do të gjykohej.⁵²

25. Lidhur me rrezikun e pengimit të procesit prej Kilajt,⁵³ Mbrojtja u referohet argumenteve të veta të mëparshme dhe parashtroi se i vetmi faktor që Gjykatësja e Procedurës Paraprake identifikoi se shton rrezikun, është fakti që Kilaj aktualisht

përkohshëm të tij dhe pjesëmarrjen e tij në seancat e ardhshme gjyqësore. *Shih* Kundërpërgjigjen, para. 17-18.

⁴⁸ Apeli, para. 24-25, 31; Kundërpërgjigjja, para. 12, 17.

⁴⁹ Apeli, para. 26.

⁵⁰ Apeli, para. 27-28.

⁵¹ Apeli, para. 29.

⁵² Apeli, para. 30.

⁵³ Në Kundërpërgjigje, Kilaj bëri të ditur se shkurtësia e argumenteve të tij lidhur me rrezikun e pengimit dhe kryerjen e veprave penale të tjera shpjegohet nga mungesa e arsytimit në Vendimin e Apeluar dhe me mbivendosjen e konsiderueshme me arsytimin lidhur me rrezikun e arratisjes. *Shih* Kundërpërgjigjen, para. 9-10.

përballet me aktakuzë të konfirmuar.⁵⁴ Sidoqoftë, sipas Kilajt, Gjykatësja e Procedurës Paraprake në mënyrë të paarsyeshme nuk mori parasysh si duhet faktin e padiskutueshëm se, edhe sikur të kishte pasur mjetet, për shembull, për të kontaktuar dëshmitarë të mundshëm në çështjen e tij dhe/ose të manipulonte ose fshihte prova mbi të cilat ZPS-ja mund të mbështetet gjatë gjykimit, ai nuk e bëri këtë.⁵⁵ Gjithashtu, Kilaj thekson se ZPS-ja tashmë ka kompjuterin e tij të bartshëm dhe një numër telefonash mobilë dhe se ZPS-ja as nuk sugjeron çfarë provash mund të fshihte ose manipulonte Kilaj në këto rrethana.⁵⁶

26. ZPS-ja përgjigjet se në Apel Kilaj nuk pranon se e vetmja arsye që ai u lirua përkohësisht në maj 2024 ishte për shkak të shproporcionalitetit të vazhdimit të paraburgimit të tij dhe se Gjykatësi i Vetëm i atëhershëm nuk gjykoi se nuk ekzistonin më rreziqe serioze.⁵⁷ ZPS-ja gjithashtu parashtroi se argumentet e Kilajt përbëjnë një numër mospajtimesh me Vendimin e Apeluar, asnjëri prej të cilëve nuk është gabim i apelueshëm.⁵⁸

27. Në lidhje me rrezikun e pengimit, ZPS-ja përgjigjet se Gjykatësi i Vetëm i atëhershëm ishte veçanërisht i shqetësuar për këtë rrezik – së bashku me rrezikun e kryerjes së veprave penale të tjera – dhe konstatoi se ky rrezik nuk mund të zbutej përmes kushteve të vendosura.⁵⁹

28. Më tej, ZPS-ja parashtroi se Gjykatësja e Procedurës Paraprake i dha peshë të mjaftueshme sjelljes së Kilajt gjatë lirimit të tij të përkohshëm.⁶⁰ Sipas mendimit të ZPS-

⁵⁴ Apeli, para. 32.

⁵⁵ Apeli, para. 32. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen, para. 14-15, ku Kilaj argumenton se sipas argumenteve të Prokurorisë ai mund të ketë pasur pa të drejtë në zotërim materiale konfidenciale, por nuk ka prova se në fakt ai ndërhyri ndaj dëshmitarëve apo manipuloi provat.

⁵⁶ Apeli, para. 32.

⁵⁷ Përgjigjja, para. 3. *Shih gjithashtu* Përgjigjen, para. 2, 17, 21-23. ZPS-ja parashtroi se tani që është konfirmuar Aktakuza, rrethanat materiale kanë ndryshuar dhe rreziqet e rënda që kanë ekzistuar gjatë të gjithë procesit nuk zhbëhen më prej (sh)proporcionalitetit të paraburgimit. *Shih* Përgjigjen, para. 21-22.

⁵⁸ Përgjigjja, para. 3, 15. *Shih gjithashtu* Përgjigjen, para. 2, 14, 20, 23.

⁵⁹ Përgjigjja, para. 15-16.

⁶⁰ Përgjigjja, para. 17, 23.

së, do të kishte qenë artificiale që sjellja e Kilajt gjatë lirimit të përkohshëm të tij të merrej parasysh ndaras nga sjellja e mëparshme e pretenduar e Kilajt, gjë që demonstroi “shpërfilljen e vazhdueshme dhe të gjithanshme” të Kilajt për ligjet dhe rregullat e Dhomave të Specializuara.⁶¹

29. Gjithashtu, ZPS-ja parashtroi se, pas konfirmimit të Aktakuzës, “faza e re e procesit shton në masë të konsiderueshme rrezikun që Kilaj mund të pengojë procesin dhe të kryejë krime të tjera, sidomos pasi po bëhet plotësisht i vetëdijshëm për sasinë e provave kundër tij”.⁶²

30. Në lidhje me rrezikun e arratisjes, ZPS-ja përgjigjet se kundërshtimi i Kilajt ndaj konstatimeve të Gjykatës së Procedurës Paraprake bazohet në shtrembërim të Vendimit të Apeluar.⁶³ ZPS-ja shton se, sidoqoftë, konstatimet e Gjykatës së Procedurës Paraprake në lidhje me këta faktorë shtesë nuk janë të gabuara.⁶⁴ Konkretisht, ZPS-ja argumenton se: (i) pesha e veprave penale për të cilat akuzohet tani Kilaj është shumë më e madhe se sa parashikimi i tij fillestar;⁶⁵ (ii) nxjerrja e provave fajësuese për Mbrojtjen është në vazhdim dhe përbën një faktor që merret gjithmonë parasysh në vlerësimin e rrezikut të arratisjes;⁶⁶ dhe (iii) me konfirmimin e akuzave, Kilaj gjendet në një pozitë të ndryshme të pakthyeshme nga ajo që ishte para Aktakuzës duke qenë se ai është i sigurt se do të gjykohej dhe bëhet më e afërt mundësia e një dënimi më të gjatë.⁶⁷

⁶¹ Përgjigjja, para. 18. *Shih gjithashtu* Përgjigjen, para. 20.

⁶² Përgjigjja, para. 19.

⁶³ Përgjigjja, para. 24. *Shih gjithashtu* Përgjigjen, para. 25-30.

⁶⁴ Përgjigjja, para. 26.

⁶⁵ Përgjigjja, para. 27-28.

⁶⁶ Përgjigjja, para. 29.

⁶⁷ Përgjigjja, para. 30.

B. VLERËSIMI I PANELIT TË GJYKATËS SË APELIT

1. Vlerësimi prej Gjykatësës së Procedurës Paraprake i sjelljes së Kilajt gjatë lirit me kusht

31. Fillimisht, Paneli kujton se vendimi i Gjykatësit të Vetëm, më 3 maj 2024, për lirim e Kilajt nuk u bazua në mungesën e rreziqeve sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit apo në mjaftueshmërinë e kushteve të lirit.⁶⁸ Faktikisht, Gjykatësi i Vetëm i atëhershëm konstatoi se këto rreziqe ende ekzistonin dhe se asnjë kusht nuk mund të kufizonte plotësisht aftësinë e Kilajt për pengimin e procesit të Dhomave të Specializuara dhe kryerjen e veprave të tjera penale.⁶⁹ Gjykatësja e Procedurës Paraprake iu referua qartësisht këtyre konstatimeve dhe i përshiu ato si të vlefshme në Vendimin mbi Fletarrestimet dhe Vendimin e Apeluar.⁷⁰

32. Kilaj parashtroi se “pika më e rëndësishme e ngritur nga Mbrojtja” është se ai demonstroi “sjellje të paqortueshme gjatë gjashtë muajve të lirit me kusht”⁷¹ dhe se Gjykatësja e Procedurës Paraprake keqpërdori diskrecionin e saj duke mos i dhënë peshë apo peshë të mjaftueshme këtij fakti.⁷² Më tej, Kilaj argumenton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk i dha peshë të mjaftueshme faktit se gjatë lirit të tij ai kishte mjetet për shkeljen e kushteve të vendosura ndaj tij nga Gjykatësi i Vetëm dhe megjithatë ai nuk i shkeli.⁷³

⁶⁸ Vendimi për Lirim, para. 41, 47, 50, 55-57, 63. Pavarësisht rreziqeve ekzistuese, Gjykatësi i Vetëm urdhëroi lirim e Kilajt mbi bazën se, duke pasur parasysh Kërkesën e ZPS-së për Leje dhe Pezullim dhe, rrjedhimisht, në pritje të dorëzimit të aktakuzës së ndryshuar kundër tij, nuk ishte më proporcionale apo e arsyeshme sipas rregullës 56(2) të Rregullores zgjatja e paraburgimit të Kilajt. *Shih* Vendimin për Lirim, para. 60-64.

⁶⁹ Vendimi për Lirim, para. 55-57, 63-64. Paneli më tej kujton se Gjykatësi i Vetëm i atëhershëm konstatoi, në vendime të njëpasnjëshme, se kushtet e propozuara nga Mbrojtja trajtonin mjaftueshëm rrezikun e arratisjes së Kilajt. *Shih* Vendimin për Lirim, para. 55; Vendimi i Tretë mbi Paraburgimin, para. 44; Vendimi i Dytë mbi Paraburgimin, para. 62; Vendimi i Parë mbi Paraburgimin, para. 59.

⁷⁰ Vendimi i Apeluar, f. 122-124; Vendimi mbi Fletarrestimet, para. 56-62.

⁷¹ *Shih* Kundërpërgjigjen, para. 12-13.

⁷² Apeli, para. 23-24.

⁷³ Apeli, para. 31-32. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen, para. 12, 17.

33. Në lidhje me argumentin për “sjellje të paqortueshme” të Kilajt,⁷⁴ Paneli pranon se i akuzuari ka qenë i liruar – për gjashtë muaj – pa incidente të raportuara.⁷⁵ Paneli pajtohet me Mbrojtjen se sjellja e një të dyshuari ose të akuzuari në pritje të gjyqimit dhe përmbushja e kushteve të liritimit/urdhrave të gjykatës janë faktorë relevantë për rishikimin e paraburgimit ose shqyrtimin e kërkesave për lëshimin e fletarrestimeve ose për lirim, ndonëse pesha që i jepet këtij faktori duhet të vlerësohet rast pas rasti.⁷⁶

34. Paneli më tej thekson se gjatë shqyrtimit të pretendimit se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk ka vlerësuar si duhet faktet në një vendim për lirim të përkohshëm, Paneli do t’u japë njëfarë vlerësimi përfundimeve të nxjerra prej Gjykatësës së Procedurës Paraprake nga provat në dispozicion dhe peshës që ajo u dha faktorëve të ndryshëm pro ose kundër paraburgimit.⁷⁷ Paneli nuk do të ndërhyjë në vlerësimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake thjesht për faktin se Paneli mund të kishte arritur në një përfundim të ndryshëm. Paneli do të ndërhyjë vetëm në rastin e një gabimi të qartë, konkretisht në rast se nuk mund të përcaktojë se si Gjykatësja e Procedurës Paraprake logjikisht mund të kishte arritur në atë përfundim mbi bazën e provave që kishte. Në rast se nuk ka gabim të qartë nga Gjykatësja e Procedurës

⁷⁴ Shih Kundërpërgjigjen, para. 13.

⁷⁵ Shih Vendimin mbi Fletarrestimet, poshtëshënimi 78.

⁷⁶ Shih ICC, *Prosecutor v. Bemba et al.*, ICC-01/05-01/13-1151, Decision Regarding Interim Release, 17 Augustus 2015, para. 20. Shih gjithashtu ICC, *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-631-Red, Judgment on the appeal of the Prosecutor against Pre-Trial Chamber II's "Decision on the Interim Release of Jean-Pierre Bemba Gombo and Convening Hearings with the Kingdom of Belgium, the Republic of Portugal, the Republic of France, the Federal Republic of Germany, the Italian Republic, and the Republic of South Africa", 2 December 2009 ("*Bemba* Appeal Decision on Interim Release"), para. 80.

⁷⁷ Shih KSC-BC-2020-06, IA003/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit lidhur me Lirimin e Përkohshëm, 30 prill 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 30 prill 2021) ("*Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e Selimit*"), para. 64; ICC, *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01/08-1626-Red, Public Redacted Version Judgment on the appeal of Mr Jean-Pierre Bemba Gombo against the decision of Trial Chamber III of 27 June 2011 entitled "Decision on Applications for Provisional Release", 19 Augustus 2011, para. 45; ICC, *Prosecutor v. Mbarushimana*, ICC-01/04-01/10-283, Judgment on the Appeal of Calliste Mbarushimana Against the Decision of the Pre-Trial Chamber I of 19 May 2011 entitled "Decision on the 'Defence Request for Interim Release'", 14 July 2011 ("*Mbarushimana* Appel Decision on Interim Release"), para. 17.

Paraprake, Paneli respekton vlerësimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake.⁷⁸ Gjithashtu, Paneli kujton se megjithëse një trup gjykues duhet të japë arsyet që mbështesin konstatimet e veta në lidhje me faktorë thelbësorë që kanë të bëjnë me një vendim, nuk është e nevojshme që të shpjegojë çdo hap të arsyetimit të vet e as të trajtojë të gjitha argumentet e paraqitura nga palët, apo çdo provë në lidhje me një konstatim konkret, në qoftë se e ka paraqitur bazën e vendimit të vet me qartësi të mjaftueshme.⁷⁹

35. Paneli kujton se Vendimi i Apeluar u lëshua pas Vendimi mbi Fletarrestimet dhe përfshiu konstatimet e bëra në të.⁸⁰ Rrjedhimisht, Paneli gjykon se është e përshtatshme të rishikohen si grup këto konstatime. Paneli thekson se në Vendimin mbi Fletarrestimet, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arriti në përfundimin se “fakti se [z. Kilaj] mund t’i ketë përmbushur kushtet që iu vunë në Vendimin për Lirimin [...], nuk do të thotë se është eliminuar rreziku”.⁸¹ Në Vendimin e Apeluar, Gjykatësja e Procedurës Paraprake mori parasysh argumentin e Kilajt në lidhje me këtë dhe “duke qenë e vetëdijshme për përmbushjen e kushteve të vendosura ndaj tij më parë” gjithsesi konstatoi se ekzistonin rreziqet sipas nenit 41(6)(b).⁸² Vendimi i Apeluar u shqiptua si vendim gojor gjatë paraqitjes së parë të Kilajt. Gjatë seancës, Gjykatësja e Procedurës Paraprake deklaroi se “pasi kam shqyrtuar të gjitha argumentet, konstatoj se asnjë prej argumenteve tuaja si mbrojtës nuk mund të ndryshojë vlerësimin tim se përmbushen kushtet e përcaktuara në nenin 41(6) të Ligjit (...)”.⁸³ Sipas mendimit të Panelit, arsyetimi i Gjykatësës së Procedurës Paraprake tregon se ajo nuk e shpërfilli

⁷⁸ *Shih p.sh.* Vendimin e Parë të Apelit mbi Paraburgimin e *Selimit*, para. 64; KSC-BC-2020-06, IA007/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit lidhur me Rishikimin e Paraburgimit, 1 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 1 tetor 2021), para. 47; *Mbarushimana* Appeal Decision on Interim Release, para. 17.

⁷⁹ Vendimi i Apeli mbi Paraburgimin, para. 51; Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin, para. 32; Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin e *Selimit*, para. 46. *Shih gjithashtu* ICTY, *Prosecutor v. Milutinović et al.*, IT-05-87-AR65.2, Decision on Interlocutory Appeal of Denial of Provisional Release During the Winter Recess, 14 December 2006, para. 15.

⁸⁰ *Shih* më lart, poshtëshënimin 31.

⁸¹ Vendimi mbi Fletarrestimet, para. 62. *Shih gjithashtu* Vendimin mbi Fletarrestimet, para. 57.

⁸² Vendimi i Apeluar, f. 121-123.

⁸³ Vendimi i Apeluar, f. 122.

këtë faktor, por duke e peshuar përkundër faktorëve të tjerë të cilëve iu referua, ajo konstatoi se ekzistonin rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit.⁸⁴

36. Ndonëse Gjykatësja e Procedurës Paraprake mund të kishte shtjelluar më shumë në lidhje me peshën që i akordoi sjelljes së Kilajt gjatë lirimit me kusht, Paneli gjykon se arsyetimi i vlerësimit të saj nuk është kaq i mangët sa të mund të thuhet se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk e përmbushi detyrimin e saj për dhënien e një mendimi të arsyetuar. Rrjedhimisht, Paneli mund të përcaktojë se si Gjykatësja e Procedurës Paraprake logjikisht mund të arrinte në atë përfundim bazuar në provat që kishte.

2. Vlerësimi i Gjykatësës së Procedurës Paraprake sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit

37. Në këtë çështje, Kilaj nuk e kundërshton konstatimin se ekziston dyshimi i bazuar se ai kreu një vepër penale nën juridiksionin e Dhomave të Specializuara. Sidoqoftë, ai kundërshton vlerësimin prej Gjykatësës së Procedurës Paraprake të rreziqeve sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit.

38. Sipas Kilajt, duke marrë parasysh sjelljen e tij të mirë gjatë lirimit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake duhet të ishte përqendruar vetëm mbi aspektin nëse faktorët pasi ai u vu në dijeni të Aktakuzës së Konfirmuar do t'i jepnin motiv *shtesë* për t'u arratisur ose për të penguar procesin.⁸⁵ Gjithashtu, Kilaj argumenton se arsyet e Gjykatësës së Procedurës Paraprake për marrjen parasysh të këtyre faktorëve si motiv shtesë janë të mangëta.⁸⁶ Paneli do t'i shqyrtojë me radhë këto argumente.

⁸⁴ Vendimi i Apeluar, f. 122-123; Vendimi mbi Fletarrestimet, para. 56-58, 61-62.

⁸⁵ Apeli, para. 20-25, 32. *Shih gjithashtu* Kundërpërgjigjen, para. 13.

⁸⁶ Apeli, para. 26. Paneli pranoi argumentin e Kilajt në lidhje me mbivendosjen, në Vendimin e Apeluar dhe për rrjedhojë në Apel, të parashtrimeve lidhur me rrezikun e arratisjes dhe rrezikun e pengimit. *Shih* Kundërpërgjigjen, para. 10.

(a) Faktorët e marrë parasysh nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake

39. Paneli kujton se vlerësimi i kryer nga një gjykatës sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit është vlerësim tërësor i rrethanave konkrete të çështjes për të përcaktuar nëse ZPS-ja paraqiti arsyetim konkret të bazuar mbi prova në mbështetje të idesë së një mundësie mjaftueshmërisht reale të ekzistencës së (një ose më shumë) rreziqeve sipas nenit 41(6)(b)(i)-(iii) të Ligjit.⁸⁷ Në kornizën ligjore të Dhomave të Specializuara nuk sugjerohet askund se Gjykatësja e Procedurës Paraprake duhej të vlerësonte vetëm nëse disa faktorë ekzistonin “para” ose “pas” konfirmimit të aktakuzës.

40. Siç u përmend më lart, në Vendimin për Lirim, Gjykatësi i Vetëm konstatoi se ende ekzistonin rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit.⁸⁸ Në Vendimin mbi Fletarrestimet dhe Vendimin e Apeluar, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se konstatimet e Gjykatësit të Vetëm në lidhje me rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit ishin ende të vlefshme.⁸⁹ Sipas mendimit të Panelit, këto rreziqe të identifikuar nga Gjykatësi i Vetëm ishin faktorë relevantë që Gjykatësja e Procedurës Paraprake duhej t’i merrte parasysh. Për mbajtjen e Kilajt në paraburgim, ajo u bazua edhe në konfirmimin e aktakuzës dhe në ecurinë e procesit, si faktorë përforcues.⁹⁰ Paneli konstaton se vlerësimi i Gjykatësës së Procedurës Paraprake ishte tërësor, ashtu siç kërkohet prej nenit 41(6)(b) të Ligjit.

(b) Vlerësimi i faktorëve prej Gjykatësës së Procedurës Paraprake

41. Lidhur me rrezikun e arratisjes dhe argumentet konkrete të Kilajt mbi kohëzgjatjen e dënimit dhe peshën e veprave penale, Gjykatësja e Procedurës

⁸⁷ *Shih p.sh.* Vendimin e Parë të Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*, para. 19. *Contra* Apeli, para. 21, 26-32; Kundërpërgjigjen, para. 13, 18.

⁸⁸ Vendimi për Lirim, para. 41, 47, 50, 55-57, 63-64. *Shih gjithashtu* para. 31 më lart.

⁸⁹ Vendimi mbi Fletarrestimet, para. 61-62, 56; Vendimi i Apeluar, f. 122-123. *Shih gjithashtu* para. 31 më lart.

⁹⁰ Vendimi mbi Fletarrestimet, para. 62. *Shih gjithashtu* Vendimin e Apeluar, f. 122-123.

Paraprake faktikisht i trajtoi, ndonëse jo hollësisht, këto argumente⁹¹ dhe i rrëzoi ato.⁹² Paneli thekson se Kilaj konkretisht argumenton se, që prej konfirmimit të aktakuzës, ai është në dijeni se rrezikon një dënim maksimal që është në masë të ndjeshme më pak i ashpër se kur iu miratua lirimi me kusht.⁹³ Paneli konstaton se ky argument nuk është bindës duke pasur parasysh faktin se akuzat e konfirmuara nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake faktikisht çojnë në një dënim të mundshëm të ngjashëm nga një deri në pesë vjet, si dënimi për të cilin Kilaj ishte në dijeni në kohën e lirimimit të tij me kusht.⁹⁴ Për më tepër, Paneli mendon se përmendja prej Kilajt e “bazës” mbi të cilën ZPS-ja mbështetet për përgjegjësinë penale të tij sipas atyre akuzave,⁹⁵ pasqyron perceptimin e Kilajt në lidhje me kuadrin e akuzave dhe fuqinë e provave të ZPS-së në këtë çështje. Gjithsesi, Paneli kujton se cilësia dhe fuqia e provave të ZPS-së janë aspekte që diskutohen në gjykim dhe se vendimi aktual në lidhje me paraburgimin nuk është vendi i përshtatshëm për trajtimin e këtij argumenti.⁹⁶

⁹¹ *Shih* Vendimin e Apeluar, f. 121 (“Në lidhje me ekzistencën e tri rreziqeve në nenin 41(6)(b) të Ligjit, fillimisht ju parashtroni se z. Kilaj që prej një viti është në dijeni për akuzat faktike dhe juridike të përfshira në Aktakuzën e Konfirmuar dhe mundësinë e një dënimi të gjatë që rrjedh prej tyre.”).

⁹² Vendimi i Apeluar, f. 122 (“Pasi kam shqyrtuar të gjitha argumentet, konstatoj se asnjë prej argumenteve tuaja si mbrojtës nuk mund të ndryshojnë vlerësimin tim se përmbushen kushtet e përcaktuara në nenin 41(6) të Ligjit.”).

⁹³ Apeli, para. 27-28.

⁹⁴ Paneli kujton se Kilaj akuzohet për (i) kryerje të veprës penale të tentativës për pengim të personave zyrtarë sipas nenit 401(2) të KPK-së; (ii) marrëveshje për të kryer veprën penale të tentativës për pengim të personave zyrtarë dhe një apo më shumë prej personave që ishin pjesë e asaj marrëveshjeje ndërmorën veprime të konsiderueshme për kryerjen e veprave penale; dhe (iii) dhënien e ndihmës në kryerjen e veprave penale të tentativës për pengim të personave zyrtarë dhe mosbindje ndaj Gjykatës. *Shih* Aktakuzën e Konfirmuar, para. 36, 40, 43, 47. Paneli thekson se dënimi i mundshëm për pengimin e personave zyrtarë ose *përpjekjen* për pengimin e tyre, është i njëjtë. Sikurse u theksua nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake në Vendimin e Konfirmimit, vepra penale sipas nenit 401(2) të KPK-së (“pengon ose tenton të pengojë”) mund të kryhet ose kur pengimi ka ndodhur faktikisht, ose kur ai është tentuar të kryhet. *Shih* Vendimin e Konfirmimit, para. 51.

⁹⁵ Apeli, para. 28, ku Kilaj argumenton se: “Akuzat për të cilat e di se do të gjykohet, dhe më konkretisht, baza për të cilën ZPS-ja thotë se ai është penalisht përgjegjës sipas këtyre akuzave, e vënë në dijeni z. Kilaj se rrezikon një dënim maksimal që është në masë të ndjeshme më pak i ashpër se në rrethanat kur iu miratua lirimi me kusht.”

⁹⁶ KSC-BC-2020-06, IA010/F00008/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit Lidhur me Rishikimin e Paraburgimit, 27 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 27 tetor 2021) (“Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e Thaçit”), para. 40. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2023-10, IA002/F00005, Vendim mbi Apelin e Haxhi Shalës kundër Vendimit mbi

42. Gjithashtu, Paneli kujton se konfirmimi i aktakuzës kundër një të akuzuari është faktor relevant që merret parasysh kur vendoset nëse vazhdimi i paraburgimit është i përligjur.⁹⁷ Ashtu sikurse theksoi Gjykatësja e Procedurës Paraprake, ndonëse gjykimi ishte vetëm një mundësi kur Kilaj ishte i dyshuar, tani pas konfirmimit të akuzave është realitet dhe rrjedhimisht, rritet gjasa e një dënimi të konsiderueshëm.⁹⁸ Për këto arsye Paneli konstaton se Kilaj nuk arrin të demonstrojë se arsyet e Gjykatësës së Procedurës Paraprake për marrjen parasysh të faktorëve pas konfirmimit të aktakuzës si motiv shtesë për t'u arratisur, janë të mangëta.

43. Në lidhje me rrezikun e pengimit, Paneli i Apelit më tej thekson se në Vendimin mbi Fletarrestimet, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstatoi se pretendohet që Kilaj të ketë keqpërdorur qëllimisht “informacion në lidhje me dëshmitarë të [Dhomave të Specializuara]” dhe pretendoi të kishte shfaqur “mospërfillje të qëllimshme për rregullat e konfidencialitetit të [Dhomave të Specializuara]”.⁹⁹ Kur konstatoi se ekzistonte rreziku i pengimit të procesit prej Kilajt, Gjykatësja e

Rishikimin e Paraburgimit, para. 51. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-06, IA008/F00004/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Kadri Veselit kundër Vendimit të Rishikimit të Paraburgimit, 1 tetor 2021 (versioni konfidencial u dorëzua më 1 tetor 2021) (“Vendimi i Dytë i Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*”), para. 23.

⁹⁷ KSC-BC-2020-07, IA002/F00005, Vendim mbi Apelin e Nasim Haradinajt kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit, 9 shkurt 2021, para. 61, *i referohet* ICC, *Prosecutor v. Mbarushimana*, ICC-01/04-01/10-163, Decision on the “Defence Request for Interim Release”, 19 May 2011, para. 41; ICTY, *Prosecutor v. Gotovina et al.*, IT-06-90-AR65.1, Decision on Ante Gotovina’s Appeal against Denial of Provisional Release, 17 January 2008, para. 15; ICTY, *Prosecutor v. Boškoski and Tarčulovski*, IT-04-82-AR65.2, Decision on Ljube Boškoski’s Interlocutory Appel on Provisional Release, 28 September 2005, para. 12. *Shih gjithashtu* ICC, *Prosecutor v. Ntaganda*, 01/04-02/06-335, Third Decision on Bosco Ntaganda’s Interim Release, 17 July 2014, para. 34, 37; ICC, *Prosecutor v. Abd-Al-Rahman*, ICC-02/05-01/20-502, Decision on the review of detention, 1 November 2021, para. 22; ICC, *Prosecutor v. Gbagbo*, ICC-02/1101/11-668, Sixth decision on the review of Laurent Gbagbo’s detention pursuant to article 60(3) of the Rome Statute, 11 July 2014, para. 41; *Bemba* Appeal Decision on Interim Release, para. 70; ICC, *Prosecutor v. Lubanga*, ICC-01/04-01/06-826 “Review of the ‘Decision on the Application for the Interim Release of Thomas Lubanga Dyilo’”, 14 February 2007, f. 6; ICC, *Prosecutor v. Katanga*, ICC-01/04-01/07-794-tENG, Second Review of the Decision on the Conditions of Detention of Germain Katanga, 12 December 2008, para. 9-10.

⁹⁸ *Shih* Vendimin e Apeluar, f. 122 (i referohet faktit se me Aktakuzën e Konfirmuar tani Kilaj është objekt i fakteve konkrete); Vendimin mbi Fletarrestimet, para. 56-57.

⁹⁹ Vendimi mbi Fletarrestimet, para. 62, *i referohet* Vendimit të Konfirmimit, para. 156-172, 195, 205-206, 211, 260, 287-288, 299; Vendimi i Apeluar, f. 122-123.

Procedurës Paraprake theksoi konkretisht dhe u mbështet, ndër të tjera, në ekzistencën e dyshimit të bazuar mirë se Kilaj bënte pjesë në një grup, ku përfshihej vetë Kilaj dhe Thaçi, udhëheqësi i grupit, me synimin për të ndikuar në mënyrë të paligjshme ndaj dëshmimeve të dëshmitarëve të ZPS-së në çështjen KSC-BC-2020-06.¹⁰⁰ Sipas mendimit të Panelit, vetë konkretësia e akuzave të konfirmuara është faktor relevant që Gjykatësja e Procedurës Paraprake e mori parasysh në vlerësimin e ekzistencës së rrezikut të pengimit të procesit.¹⁰¹

44. Më tej, Paneli i referohet argumentit të Kilajt se, që prej 15 dhjetorit 2023, data e parashtrimit të parë të ZPS-në në lidhje me rishikimin e paraburgimit, ai ka qenë në dijeni të provave të ZPS-së kundër tij.¹⁰² Paneli thekson se Gjykatësja e Procedurës Paraprake është më së miri në gjendje të vlerësojë nëse rrethanat lidhur me nisjen e afërt të gjykit kanë shtuar rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit, ndër të tjera, nëse i akuzuari do të pengojë procesin në rast se lirohet. Paneli e gjykon të arsyeshëm përfundimin e Gjykatësës së Procedurës Paraprake se motivet e Kilajt për pengimin e procesit u shtuan me afrimin e nisjes së gjykit duke mbajtur parasysh se ai do të ketë qasje në informacion tejet të ndjeshëm, si për shembull informacion konfidencial në lidhje me dëshmitarë dhe prova të tjera ku ZPS-ja mund të mbështetet gjatë gjykit kundër tij.¹⁰³ Në lidhje me këtë, Paneli kujton se njohuritë e shtuara të të akuzuarit për provat e ZPS-së përmes nxjerrjes së provave, përfshirë të identiteteve të dëshmitarëve, mund të jenë faktor relevant që merret parasysh bashkë me faktorë të tjerë për të përcaktuar ekzistencën e rrezikut të pengimit.¹⁰⁴ Në mënyrë të ngjashme,

¹⁰⁰ Vendimi mbi Fletarrestimet, para. 62. *Shih gjithashtu* Vendimin e Apeluar, f. 123.

¹⁰¹ *Shih ngjashëm*, Vendimin e Dytë të Apelit mbi Paraburgimin e *Haradinajt*, para. 45.

¹⁰² Apeli, para. 29-30. *Shih gjithashtu* Apelin, para. 32.

¹⁰³ Vendimi mbi Fletarrestimet, para. 62. *Shih gjithashtu* Vendimin e Apeluar, f. 123.

¹⁰⁴ KSC-BC-2020-04, IA005/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin kundër Vendimit në lidhje me Rishikimin e Vendimit të Kthyer mbi Paraburgimin dhe për Rishikimin e Rregullt të Paraburgimit të Pjetër Shalës, 19 korrik 2022 (versioni konfidencial dhe ex parte u dorëzua më 19 korrik 2022), para. 30. *Shih gjithashtu* Vendimin e Dytë të Apelit mbi Paraburgimin e *Veselit*, para. 31; Vendimin e Dytë të Apelit mbi Paraburgimin e *Thaçit*, para. 38; KSC-BC-2020-04, IA003/F00005/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Pjetër Shalës kundër Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit, 11 shkurt 2022 (versioni konfidencial u dorëzua më 11 shkurt 2022), para. 36.

në Gjykatën Penale Ndërkombëtare, dhomat gjyqësore kanë konstatuar se caktimi i datës së nisjes së gjykimit dhe fakti se çështja gjyqësore e të akuzuarit po përparonte mund të jetë motiv që i akuzuari të arratiset ose të ndërhyjë ndaj dëshmitarëve.¹⁰⁵

45. Gjithashtu, Paneli rrëzon argumentin e Kilajt se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk mori mjaftueshëm parasysh faktin se ai kishte mjetet dhe mundësinë për t'i kontaktuar dëshmitarët e mundshëm në çështjen e tij, ose për të penguar procesin me mënyra të tjera, por nuk e bëri këtë.¹⁰⁶ Paneli kujton se pesha që duhet t'i jepet përmbushjes së kushteve të lirimit nga ana e të akuzuarit duhet të vlerësohet rast pas rasti.¹⁰⁷ Në lidhje me këtë çështje, arsyetimi i Gjykatësës së Procedurës Paraprake tregon se ajo e mori parasysh faktin se Kilaj mund t'i kishte përmbushur kushtet që iu vunë gjatë lirimit të tij, por konstatoi se kjo nuk do të thoshte se ishte eliminuar rreziku që ai të kontaktonte dëshmitarët e mundshëm në këtë çështje, ose të pengonte procesin me mënyra të tjera në të ardhmen.¹⁰⁸ Paneli gjykon se sjellja e mirë e Kilajt gjatë lirimit kufizohet në demonstrimin se është realizuar pritshmëria e përmbushjes së kushteve për lirim e përkohshëm të urdhëruar më parë. Paneli konstaton se Gjykatësja e Procedurës Paraprake nuk e keqpërdori diskrecionin e saj në mënyrën se si e vlerësoi këtë faktor konkret.

46. Si përfundim, Paneli konstaton se argumenti i Kilajt se ZPS-ja tashmë ka kompjuterin e tij të bartshëm dhe një numër telefonash mobilë dhe se ZPS-ja as nuk sugjeron se çfarë provash mund të fshihte ose manipulonte Kilaj në këto rrethana,¹⁰⁹ nuk është bindës. Ndonëse, sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit, ZPS-ja ka detyrimin të vërtetojë domosdoshmërisë e paraburgimit,¹¹⁰ kjo barrë nuk shtrihet deri në detyrimin

¹⁰⁵ *Shih p.sh. ICC, Prosecutor v. Yekatom and Ngaïssona*, ICC-01/14-01/18-643-Red, Public redacted version of Decision on the Second Yekatom Defence Motion for Interim Release, 7 September 2020, para. 32.

¹⁰⁶ Apeli, para. 32.

¹⁰⁷ *Shih* më lart, para. 33.

¹⁰⁸ Vendimi mbi Fletarrestimet, para. 62. *Shih gjithashtu* Vendimin e Apeluar, f. 123. *Shih gjithashtu* më lart, para. 33-36.

¹⁰⁹ Apeli, para. 32.

¹¹⁰ Vendimi i Parë i Apelit mbi Paraburgimin, para. 29.

e ZPS-së për renditjen e të gjitha mjeteve të mundshme që mund të përdoren nga Kilaj për pengimin e procesit nëse lirohej.

47. Bazuar në sa më lart, Paneli konstaton se Kilaj nuk arrin të demonstrojë se vlerësimi prej Gjykatës së Procedurës Paraprake i rreziqeve sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit është aq i padrejtë apo i paarsyeshëm saqë përbën keqpërdorim të diskrecionit.

V. VENDIM

48. Bazuar në këto arsye, Paneli i Gjykatës së Apelit:

RRËZON Apelin në tërësi;

URDHËRON riklasifikimin e Përgjigjes (IA001/F00003) si publike, sipas rregullës 82(5) të Rregullores;

URDHËRON Kilajn të dorëzojë versionet e redaktuara publike të Apelit (IA001/F00001/COR) dhe të Kundërpërgjigjes (IA001/F00004), ose të bëjë të ditur, me anë të një parashtrimi, nëse ato mund të riklasifikohen si publike brenda dhjetë ditësh nga njoftimi i këtij Vendimi; dhe

UDHËZON Zyrën Administrative të bëjë riklasifikimin e Apelit (IA001/F00001/RED) dhe të Kundërpërgjigjes (IA001/F00004), pasi dhe nëse Kilaj do të bëjë të ditur se ato mund të riklasifikohen.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mishelë Pikar,
Kryegjykatëse

E martë, 28 janar 2025

Në Hagë, Holandë